




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendim Nr.109/24

Datë: 24.12.2024

Duke u bazuar në nenin 17, 26, 27, 29, 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 dhe neni 55 paragrafi 1 nënparagrafi 13, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave Për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret Për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Përcaktimin e Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të raportit të sekretariatit, me datën 24.12.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. Konstaton se, nuk është shtrembëruar konkurrenca e tregut sipas, ligjit;
- II. Mbyllet procedura hetimore, ndaj ndërmarrjes Meridian Corporation sh.p.k., e hapur sipas Konkluzionit Nr.47/2024, datë 13.05.2024;
- III. Obligohet Sekretariati, që të kujdeset për zbatimin e këtij, Vendimi.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës Kosovës (tutje në tekst ref. Autoriteti), me datë 13.05.2024, ka nxjerrë Konkluzion me Nr. 47/2024 dhe Nr. prot. 299/24-011/D, për Fillim të Procedurës Hetimore, ndaj ndërmarrjes Meridian Corporation sh.p.k., (tutje ref. Meridian) e cila ofron tregtinë me shumicë dhe pakicë të shitjes në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, nën dyshimin se e njëjta ka realizuar transaksione, përkatësisht blerje të aksioneve, apo fitim të kontrollit, mbi ndërmarrjet e tjera përkatësisht mbi ndërmarrjen Spar Kosova J.S.C (tutje Spar, ref. targeti), në tregun përkatës, pa paraqitur kërkesën për lejimin e përqendrimit në Autoritetin e Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Me këtë veprim mbi ndërmarrjen Meridian Corporation, Autoriteti ka ngritur dyshimet se e njëjta, ka shkelur dispozitat e nenit 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të cilave ndërmarrja Meridian, dyshohet se ka qenë e obliguar që të bëjë Njoftimin e Përqendrimit. Më datë 07.06.2024, Autoriteti ka pranuar komentet e palës në procedurë.

Autoriteti, ka analizuar dokumentet dhe komentet Nr.351/24-11/H e kërkuara me, Konkluzionin datë 13.05.2024, për ndërmarrjen, Meridian Corporation:

1

UPB

J.M.

SGL

- Pasqyrat financiare të Meridian Corporation sh.p.k., për vitet 2020, 2021, 2022, 2023;
- Marrëveshjet (kontratat) për shitblerjen e aksioneve.
- Informatat e biznesit (Certifikata e regjistrimit, Informacionet e biznesit dhe Certifikata e numrit fiskal);

Palë në procedurë

Meridian Corporation Sh.p.k., me adresë Prishtinë, Rruga Hyrije Hana, p.n., me numër unik 810482521, e regjistruar pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, në Kosovë (ARBK), e cila ofron shërbimet e shitjes me shumicë dhe pakicë në supermarkete në tregun përkatës, lidhur me shitblerjen (transaksionin) mbi targetin "Spar Kosova" J.S.C. Sh.p.k., me numër unik 810118225, e regjistruar për ofrimin e shërbimeve të tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani në tregun përkatës.

Objekti i Hetimit

Kontrata për blerjen e 100% të aksioneve, e lidhur me datë 01.10.2020, të cilën palët e kanë realizuar pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit, sipas nenit 13 dhe 15 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Meridian Corporation Shpk, me numër unik 810482521, e regjistruar për ofrimin e shërbimeve të tregtisë me shumicë dhe pakicë të shitjes në supermarkete në tregun përkatës: "Spar Kosova" J.S.C. Shpk me numër unik 810118225, e regjistruar për ofrimin e shërbimeve të tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani në tregun përkatës.

Të gjeturat nga hetimi i ndërmarrjeve, sipas Konkluzionit Nr. 47/2024 të datës 13.05.2024.

Pjesëmarrësit në "Përqendrim" nuk arrijnë pragun ligjor të qarkullimit.

1. Autoriteti, ka filluar hetimin e ndërmarrjes Meridian Corporation Sh.p.k., për arsye se e njëjta ka blerë ndërmarrjen e Spar Kosova L.L.C.
2. Provë: ndryshim i pronësisë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ARBK.
3. Kontratë/Marrëveshje Franshizë të markës/brenditë, Spar Kosova është ndërmarrje totalisht e pavarur dhe e menaxhuar sipas standardeve të vendosura vet ndërmarrja, e njëjta nuk konsiderohet ndërmarrje e lidhur, me Spar International B.V.
4. Në kohën e transaksionit mes dy palëve, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-229, neni 15 paragrafi, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 parasheh që një përqendrim duhet të njoftohet nëse plotësohen kushtet e qarkullimit/të hyrat në mënyrë kumulative, pra qarkullimi në tregut ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm, e që në këtë rastë Spar Kosova në bazë së Kontratës dhe vlerësimit të dokumentacionit nuk konsiderohet ndërmarrje e ndërlidhur me Spar International B.V., që do të thotë se nuk përmbushen kushtet në mënyrë kumulative.
5. Bazuar në analizën e strukturës së tregut përkatës, pala në procedurë nuk ka pozitë dominuese, andaj, ky transaksion nuk mund të ndikojë në krijimin dhe forcimin e pozitës dominuese, e cila mund të dëmtojë ndjeshëm konkurrencën.

Bazuar në nenin 15 i Ligjit Nr. 03/L-229, Detyrimi për Njoftimin e realizimit të Përqendrimit

AB

J.M. SGL

Me qëllim të marrjes së vendimit për lejimin e përqendrimit sipas këtij ligji, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar të paraqesin në Autoritet qëllimin e përqendrimit nëse në mënyrë kumulative janë përmbushur këto kushte:

1.1. të hyrat e konstatuar të ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar janë më shumë se njëzet (20) milion Euro, sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprinë vitit të përqendrimit, nëse së paku një pjesëmarrës ka selinë në Republikën e Kosovës;

1.2. të hyrat e përgjithshme të së paku dy (2) pjesëmarrës në përqendrim në tregun e brendshëm të Kosovës, janë më shumë se tre (3) milionë Euro sipas raporteve financiar e që i paraprinë vitit të përqendrimit.

Pas shqyrtimit të Raporteve Financiare, marrë për bazë qarkullimin e palëve në përqendrim, për vitin financiar që i paraprin vitit të përqendrimit, bazuar në nenin 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., dhe 1.2., **nuk përmbushet detyrimi për të kërkuar lejimin e Përqendrimit.**

Komisioni, ka analizuar dhe konstaton se ndërmarrja Meridian Corporation sh.p.k., me rastin e lidhjes së kontratës për shitblerjen e aksioneve të ndërmarrjes Spar Kosova J.S.C., nuk ka qenë e obliguar të parashtojë kërkesën, për Njoftim të Përqendrimit, sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, **rrjedhimisht nenit 15 të Ligji Nr. 03/L-229 (ligji i vjetër).**

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit, duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 1 nënparagrafi 13 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi, menjëherë.

AUTORITETI I KONKURRENCËS **Komisioni**

Neime Binaku – Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj

Anëtare

Florent Mehmeti

Anëtar

Salihe Gashi- Loku

Anëtare

- Pala në procedurë
- Arkiva
- Publikohet në web faqen e Autoritetit

AB